

Titulli i lëndës: MBROJTJA E TRASHËGIMISË ARKITEKTURALE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale
Niveli:	Msc
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	VI
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Florina Jerliu
Të dhënat kontaktuese:	florina.jerliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda është konceptuar që të mundësojë studentët të zhvillojnë të kuptuarit e nocioneve dhe koncepteve të lidhura me trashëgimisë arkitekturale, si dhe të rëndësisë dhe parimeve të mbrojtjes së saj në kontekstin historik dhe gjeografik. Lënda ofron pasqyrë të përgjithshme të çështjeve që lidhen me konceptimin e mbrojtjes, kategoritë dhe dokumentimin e trashëgimisë së ndërtuar, bashkë me parimet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Për shkak të nevojës gjithnjë e më të madhe për ndërrime në mjedisin e ndërtuar, dokumentimi shkencor i trashëgimisë arkitekturale (përnjohja, hulumitim, rilevimi) do të mësohen në këtë lëndë si segment i punës praktike që e aftëson studentin për punën e ardhshme në definimin e nivelit të intervenimit konservues-restaurues, prezentimin optimal, si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë arkitekturale
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që studentët të njihen me konceptet dhe debatet akademike në fushën e trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe të trashëgimisë arkitekturale e peizazheve urbane në mënyrë më specifike; të krijojnë ndjeshmërinë në identifikimin dhe absorbimin e të dhënave dhe analizës “in situ” të monumenteve, si dhe në rilevim dhe hartim të dokumentacionit grafik, pamor dhe përshkrimor të trashëgimisë arkitekturale
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none">– zhvillojnë ndjeshmërinë për aplikim të parimeve të mbrojtjes në ndërtesat dhe mjediset e trashëgimisë së ndërtuar– identifikojë dhe referencojë dokumentet doktrinare ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore (konventat dhe kartat ndërkombëtare të UNESCO, ICOMOS, KE, etj)– aftësohet për punë hulumtuese dhe praktikë të rilevimit dhe dokumentimit, nën mbikqirjen e përbashkët të mësimdhënësve të kursit dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore të Kosovës;

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			100
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata tematike, diskutime, vizita studimore, punës praktike në terren (përnjohja, rilevimi) , detyra semestrare (hartimi i dokumentacionit teknik të gjendjes ekzistuese me analiza të devastimit dhe faza të ndërtimit).Kopja e dokumentacionit teknik i vehet në dispozicion institucioneve bashkëpunuese të trashëgimisë kulturore të Kosovës		
Metodat e vlerësimit:	<i>(Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.</i> Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrare 50%, Vlerësimi nga testet 20% ose Provimi final 40%		
Literatura primare:	F.Jerliu (2016) Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore. Historia, konceptet, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Libri Shkollor, Prishtinë J. Jokilehto (1999). A History of Architectural Conservation, Butterworth-Heinemann, UK R. Thornes, J. Bold. Eds. (1998). Documenting the Cultural Heritage, Getty Information Institute. ICOMOS (2004). International Charters. Conservation and Restoration, 2nd edition		
Literatura shtesë:	Miles Glendinning (2013). The Conservation Movement: A History of Architectural Preservation. Antiquity to modernity, Routledge Bernard M. Feilden (1982). Conservation of Historic Buildings. Third edition. Architectural Press, Oxford E. Riza (2002) Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës. Instituti I Monumenteve të Kulturës, Tiranë, A. Meksi (2004) Restaurimi i monumenteve të arkitekturës, Uegen, Tiranë		

Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	Ushtrimet
Java 1:	Hyrje në konceptet dhe metodologjinë e mbrojtjes	Ushtrim metodik
Java 2:	Nocionet dhe definicioni i trashëgimisë kulturore, arsyet për mbrojtjen dhe shkaqet e dëmitimit;	Ndarja e Detyrave / Grupeve
Java 3:	Kategoritë e trashëgimisë së ndërtuar	Ushtrim auditor
Java 4:	Historia e mbrojtjes gjatë kohës së re (renesanca, baroku dhe klasicizmi, neoklasicizmi, romantizmi dhe ringjallja mesjetare: (shek.XV – XIX)	Pune ne terren (sipas planit dinamik)
Java 5:	Dokumentimi i trashëgimisë së ndërtuar	Pune ne terren
Java 6:	Mbrojtja doktrinare e trashëgimisë së ndërtuar (gj. dytë e shek. XIX)	Puna në terren
Java 7:	Teoritë dhe konceptet moderne të mbrojtjes - Alois Riegl, Gustavo Giovannoni, Cesare Brandi	-
Java 8:	Vlerësimi i parë intermediar	-
Java 9:	Ndikimi i mbrojtjes Evropiane në botë; Organizatat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	-
Java 10:	Trashëgimia kulturore në trojet shqiptare	Puna kontrolluese në klase
Java 11:	Hyrje në parimet e mbrojtjes ; Mbrojtja Preventive	Puna kontrolluese në klase
Java 12:	Parimet e konservimit, restaurimit dhe renovimit	Puna kontrolluese në klase
Java 13:	Parimet e mirëmbajtjes, riparimit/stabilizimit dhe rehabilitimit/modernizimit	Puna kontrolluese në klase
Java 14:	Parimet e rindërtimit (rikonstruimi), rikompozimit (anastiloza) dhe rilocimit (zhvendosja)	Puna kontrolluese në klase
Java 15:	Vlerësimi i dytë intermediar	Prezantimi dhe Dorëzimi final i detyrës

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjëratat dhe vizitat studimore janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për dokumentimin e monumentit/lokalitetit, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale.

Shënim | Nëse detyra seminarike e një studenti vlerësohet nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final.